



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

014.nr. 031/-0308928/19 më 20.12.2017

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), neni 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, dhe të nenit 19 të Rregullores së MF-së, nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, Kryetari i Komunës së Prishtinës nxjerr këtë

V E N D I M

I

Miratohet Vendimi për caktimin e komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare - autoambulancave.

II

Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Sheqir Sylja, vozitës,
2. Bekim Tahiri, vozitës dhe
3. Migjen Kosumi, inf/vojitës.

III

Detyra e komisionit në pikën II të këtij vendimi, është inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore, verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur, identifikimi i pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit dhe përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit.

IV

Ky komision është organ i përkohshëm dhe mandati i tij përfundon me kryerjen e inventarizimit vjetor për vitin 2017.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Prishtinës.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti